

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.

**Pasqyrat financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(bashkë me Raportin e Audituesit të Pavarur)

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur.....	i
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes	6
3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	13
4. Shpallje të reja të kontabilitetit	14
5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit.....	14
6. Administrimi i rrezikut financiar	20
7. Vlera e drejtë.....	26
8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	27
9. Depozita me afat me bankat	27
10. Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	28
11. Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	28
12. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit.....	28
13. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	29
14. Aktive të risigurimit	30
15. Investime në filiale me kosto dhe borxhi i varur për filiale	30
16. Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale, aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime qiraje	31
17. Aktive të tjera	33
18. Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme.....	33
19. Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafitur	34
20. Detyrime të tjera.....	35
21. Kapitali aksionar.....	35
22. Rezerva e rrezikut të sigurimit.....	35
23. Prime të shkruara bruto.....	35
24. Prime të shkruara ceduar risiguruesve.....	36
25. Të ardhura të tjera.....	36
26. Shpenzime të marrjes në sigurim.....	36
27. Shpenzime administrative	37
28. Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit.....	37
29. Të ardhurat nga investimet dhe interesat.....	37
30. Tatim mbi fitimin	38
31. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	39
32. Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura	39
33. Menaxhimi i kapitalit.....	41
34. Ngjarje pas datës së raportimit	41
Skedule plotësuese (të paaudituar)	a

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigal Uniq Group Austria SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale të Sigal Uniq Group Austria SH.A. ("Shoqëria") janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare individuale të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024;
- pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën individuale të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale, të cilat përfshijnë politika domethënëse kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare individuale të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK") dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë që janë të zbatueshme për auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin Vjetor, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare individuale dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare individuale nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vendosen në dispozicion dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare individuale apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS/NIPT: L92014010J
Regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë me Vendim nr. 701, 03.07.2020 të Komitetit të Regjistrimit

Kur ne të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se në të gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këtë çështje drejtimit.

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare individuale

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale sipas kërkesave të Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", dhe për kontrollet e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtuesit synojnë që Shoqëria të likuidohet apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare individuale

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare individuale në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare individuale, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose shmangie të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë.

Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.



Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

30 prill 2025

Tiranë, Shqipëri



Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Pasqyra individuale e pozicionit financiar – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8	105,262	127,496
Depozita me afat me bankat	9	5,558,507	5,239,158
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	10	700,117	624,830
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	11	37,343	34,654
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	12	438,741	410,157
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	13	426,939	409,725
Aktive të risigurimit	14	1,153,599	827,706
Tatim fitimi i arkëtueshëm		20,538	51,705
Investime në filiale me kosto	15	2,223,050	2,223,050
Borxh i varur për filiale	15	104,317	108,536
Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale, aktive me të drejtë përdorimi	16	870,305	915,254
Aktive të tjera	17	91,880	103,820
Totali i Aktiveve		11,730,598	11,076,091
Detyrimet			
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme	18	3,631,909	3,185,199
Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafitur	19	2,945,359	2,663,953
Provizione për fondin e kompensimit		149,534	173,895
Detyrime qiraje	16	75,259	125,977
Detyrime të tjera	20	412,610	460,378
Totali i Detyrimeve		7,214,671	6,609,402
Kapitali			
Kapitali aksionar	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva e rrezikut të sigurimit	22	260,496	260,496
Fitimi i pashpërndarë		2,022,522	1,973,284
Totali i Kapitalit		4,515,927	4,466,689
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		11,730,598	11,076,091

Këto pasqyra financiare individuale janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 31 mars 2025 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:


Arni Ponari
Drejtor i përgjithshëm


SIGAL
UNIQA GROUP AUSTRIA
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE


Klement Mersini
Drejtor i departamentit të
financës

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Sigal Uniq Group Austria SH.A.**Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	2024	2023
Prime të shkruara bruto	23	5,729,743	5,499,080
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	19	(281,406)	(166,264)
Prime të fituara bruto		5,448,337	5,332,816
Prime të shkruara ceduar risiguruesve	24	(883,448)	(966,819)
Ndryshimi në rezervën e risigurimit për primet pafituara	19	60,737	33,906
Të ardhura neto nga veprimtaria e sigurimit		(822,711)	(932,913)
Të ardhura të tjera	25	67,730	75,514
Të ardhura neto		4,693,356	4,475,417
Ndryshimi në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme	18	(446,711)	(256,005)
Ndryshimi në pjesën e risigurimit në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme	18	139,958	(38,464)
Dëme të paguara	18	(2,042,279)	(1,384,548)
Dëme të paguara nga risiguruesit	18	317,120	113,158
Shpenzime për dëme neto		(2,031,912)	(1,565,859)
Shpenzime të marjes në sigurim	13,26	(812,032)	(862,901)
Shpenzime administrative	27	(1,337,792)	(1,168,174)
Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit	28	(140,777)	(163,149)
Fitimi operativ		370,843	715,334
Të ardhura nga interesat dhe investimet	29	302,126	162,398
Shpenzime interesi		(4,837)	(6,662)
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit		(220,909)	(478,599)
Fitimi para tatimit		447,223	392,471
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	30	(47,985)	(58,760)
Fitimi i vitit		399,238	333,711
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që kalojnë më pas në fitim humbje		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		399,238	333,711

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rrezikut të sigurimit	Fitim i pashpërndarë	Totali
Gjëndja më 1 janar 2023	2,232,909	260,496	1,939,573	4,432,978
Fitimi i vitit	-	-	333,711	333,711
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	333,711	333,711
Dividendë të paguar	-	-	(300,000)	(300,000)
Gjëndja më 31 dhjetor 2023	2,232,909	260,496	1,973,284	4,466,689
Fitimi i vitit	-	-	399,238	399,238
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	399,238	399,238
Dividendë të paguar	-	-	(350,000)	(350,000)
Gjëndja më 31 dhjetor 2024	2,232,909	260,496	2,022,522	4,515,927

Sigal Uniq Group Austria SH.A.
Pasqyra individuale e flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese			
Fitimi para tatimit		447,223	392,471
Rregullime për:			
Amortizimi	27	139,252	146,700
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		17,983	38,314
Të ardhura nga interesi	29	(122,410)	(76,672)
Të ardhura nga dividendi	29	(174,879)	(85,726)
Shpenzime interesi		4,837	6,662
Humbje nga kursi i këmbimit nga borxhit i varur për filiale		4,220	8,757
Vlera e drejtë e investimeve të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes		(2,689)	(2,136)
Çvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	12	63,095	37,285
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese përpara ndryshimeve në:		376,632	465,655
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit		(34,511)	(25,562)
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		17,214	39,792
Aktive të risigurimit		(200,695)	4,559
Aktive të tjera		(113,258)	126,139
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme		446,711	256,006
Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafitur		281,406	166,264
Detyrime të tjera		(72,129)	25,618
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		324,738	592,816
Tatim fitimi i paguar		(120,228)	(135,775)
Interes i arkëtuar		116,344	39,754
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë shfrytëzuese neto		697,486	962,450
Flukse dalëse nga blerja e aktiveve afatgjata materiale		(100,471)	(121,176)
Flukse hyrëse nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			-
Ndryshimi neto i depozitave me afat me bankat		(313,283)	85,129
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar		(75,288)	(623,280)
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes			-
Dividendë të arkëtuar		174,879	85,727
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese neto		(314,163)	(573,600)
Dividendë të paguar	21	(350,000)	(300,000)
Pagesa të qirasë	16	(55,557)	(45,608)
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë financuese neto		(405,557)	(345,608)
Rritja/ (ulja) në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre gjatë vitit		(22,234)	43,242
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		127,496	84,254
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	8	105,262	127,496

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare të veçanta të Sigal Uniqa Group Austria SH.A. ("Shoqëria"), referuar më tej si pasqyra financiare individuale, të përgatitura në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve" dhe kuadrin ligjor mbikëqyrës të sigurimeve në Shqipëri.

Shoqëria është themeluar dhe e ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri që nga viti 1999 si shoqëri aksionare sigurimi në përputhje me ligjin nr. 8081, datë 7 mars 1996, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 20863, datë 22 shkurt 1999. Shoqëria aktualisht është subjekt i ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" datë 4 korrik 2014 ("Ligji i sigurimeve"). Gjatë vitit 2023, shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë ishte UNIQA Österreich Versicherungen AG, Vjenë, Austri. Shoqëria mëmë e grupit është UNIQA Versicherungsverein Privatstiftung, Vjenë, Austri.

Shoqëria mëmë ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e aksioneve më 21 nëntor 2024 me Sigal Business Center SH.P.K, e cila është në pronësi të plotë të Z. Ponari, për transferimin e aksioneve të saj. Marrëveshja është e kushtëzuar nga miratimi i autoriteteve rregullatore të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe nga disa kushte të tjera, dhe mbetet e vlefshme deri në nëntor 2025. Transferimi i pronësisë do të ndodhë sapo të përfundojë miratimi i marrëveshjes nga tre autoritetet dhe të kryhet pagesa. Në datën e këtyre pasqyrave financiare, pronësia ende nuk ishte transferuar pasi miratimet nga autoritetet rregullatore përkatëse nuk ishin marrë.

Aktiviteti kryesor: Shoqëria ofron produkte të sigurimit të jo-jetës si sigurime për mjete motorike, sigurime të pasurisë, sigurime të shëndetit, marinës, aviacionit dhe linjave të tjera të biznesit.

Vendndodhja e biznesit: Adresa e Shoqërisë është Blv. "Zogu I", nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes Këto pasqyra financiare individuale paraqiten në lekë ("lekë") të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt. Leku shqiptar është gjithashtu monedha funksionale e Shoqërisë, monedhë e mjedisit primar ekonomik në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj.

Shoqëria zotëron filiale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të cilat operojnë në fushën e aktivitetit të sigurimit të jetës dhe jo-jetës, si dhe shoqëri të menaxhimit të fondeve të investimeve.

Aktiviteti në Shqipëri

Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. (99.9% në pronësi të Shoqërisë) - u krijua si një filial për të ofruar produktet e sigurimit të jetës në Shqipëri që nga viti 2004.

Shoqëria Administruese e Fondeve "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A. (51% të pronësisë të Shoqërisë) është shoqëri administruese e fondeve të investimeve. Që prej qershorit 2024, emri i shoqërisë ndryshoi në UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Aktiviteti në Kosovë

Sigal Uniqa Group Austria SH.A. - Prishtina (100% në pronësi të Shoqërisë) është themeluar në vitin 2003 si degë e Shoqërisë, në territorin e Kosovës, administruar në atë kohë nga OKB. Licenca është lëshuar më 23 tetor 2003 nga Autoriteti i Bankave dhe i Pagesave të Kosovës (tani Banka Qendrore e Kosovës). Në vitin 2012, dega ndryshoi statusin e saj ligjor dhe u shndërrua në një filial të Shoqërisë.

Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. - Prishtina (100% në pronësi të Shoqërisë) është themeluar më 10 maj 2011 për të ofruar sigurimin e jetës në Kosovë.

Aktiviteti në Maqedoni

Uniqa A.D. Skopje (99.94% ownership by Sigal Uniqa Group Austria SH.A.) was established by the Uniqa A.D. Skopje (99.94% në pronësi të Shoqërisë) është themeluar më 15 prill 2004 si Sigal AD - Shkup. Linjat kryesore të veprimtarisë janë sigurimet e lidhura me mjetet motorike (MTPL, policat kufitare, kartoni jeshil), pasuri dhe aksidentet. Gjatë vitit 2007 emri zyrtar u ndryshua në "UNIQA AD Skopje".

Uniqa Life AD Skopje (100% në pronësi të Shoqërisë) u themelua më 29 qershor 2011 për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës në Maqedoni.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm. Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2024 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare individuale është i përbërë nga:

Andreas Brandstetter	Kryetar
Wolfgang Kindl	Anëtar
Mag Gerald Muller	Anëtar
Georgios Bartzis	Anëtar
Vinzenz Benedict	Anëtar

2. Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike të modifikuar nga matja e vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Shoqëria për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare individuale.

Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale për të raportuar mbi aktivitetin e saj dhe rezultatet tek autoritetet tatimore dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare Shqiptar ("AMF") në Shqipëri. Gjithashtu, Shoqëria përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me Ligjin 52/2014 për Shoqërinë dhe filialet e saj (Grupi). Në pasqyrat financiare të konsoliduara, filialet janë konsoliduar në mënyrë të plotë. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të disponueshme dhe mund të aksesohen në faqen zyrtare të Shoqërisë. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Grupit në tërësi. Përgatitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që drejtimi të kryejë vlerësimet dhe parashikimet përkatëse. Gjithashtu, drejtimi ushtron gjykimin e vet në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Shënimet shpjeguese që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose shënimet ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për këto pasqyra financiare individuale janë të paraqitura në shënimin 3.

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Investimet në filiale maten me koston duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi. Kostot e transaksionit kapitalizohen si pjesë e koston së investimit. Kostot e transaksionit janë kostot që i atribuohen drejtpërdrejt investimit si: pagesa profesionale për shërbime ligjore, taksa transferimi dhe kostot të tjera të lidhura me blerjen.

Kostoja fillestare e investimeve përfshin gjithashtu detyrimet e kushtëzuara. Rimatja e mëpasshme e shumës së kushtëzuar të klasifikuar si detyrim financiar rregullohet kundrejt kostove të investimit.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues që vlera kontabël e një investimi mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (më e larta midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e tij, vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme. Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të të ardhurave nga shitja dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen nëse shitja rezulton në një transferim nga filiali në sipërmarrje të përbashkët ose një pjesëmarrje e matur me kosto.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Zërat jo-monetarë që maten me koston historike në monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat në të cilat Shoqëria pranon të ndërmarrë një rrezik nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të dëmshpërblejë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurt në të ardhmen (ngjarja sigurorese) e cila ka efekte negative dhe ndikon policë-mbajtësin, konsiderohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose në disa norma interesi specifike, çmime të letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekse të çmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indekset e kreditimit ose treguesë të tjerë, të siguruar në rastin e treguesve jofinanciarë kur ai nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i) Kontrata e përgjithshme e sigurimit

Detyrimet e veprimtarisë së sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e të pafituara, rreziku i detyrimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e detyrimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e veprimtarisë së sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të pa - raportuara. Shoqëria nuk i aktualizon detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të posaçme. Shoqëria ka përdorur kërkesat e AMF-së (rregullatori) për të përcaktuar detyrimet e veprimtarisë së sigurimit.

ii) Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin e drejtpërdrejtë pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëposhme. Primet paraqiten pa përfshirë detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet. Primet konsiderohen të fituar që nga data kur i bashkëlidhet rrezikut, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi për të cilat shuma e detyruar vlerësohet të jetë e paarkëtueshme fshihen.

iii) Rezerva e primit të pafituar ("UPR")

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha linjat e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet se do të fitohet në vitin pasardhës, duke përdorur metodën proporcionale 1/365, e rregulluar në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Rezerva e primit të pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e shkruara të cilat paraqiten bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe gjithashtu përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet.

iv) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë shpenzimet e ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave të marra, të cilat korrespondojnë me rezervën e primit të pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e shpenzimeve të marrjes në sigurim si përqindje në planin teknik të sigurimeve dhe që lidhen me periudhat ndërmjet fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të afatit të kontratës së sigurimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga marrja në sigurim e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot e drejtpërdrejta, siç janë komisionet e marrjes në sigurim.

v) Dëmet e ndodhura nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga shpenzimet për kompensimin dhe trajtimin e dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar së bashku me rregullime të provizionit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe llogaritjen e provizionit të dëmeve të ndodhura por ende të paraportuara, efektin e ngjarjeve të parashikuara brendshme dhe të jashtme, të tilla si ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparshme. Provizionin për dëmet e papaguara nuk aktualizohen. Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Provizioni për dëmet e ndodhura por të paraportuara vlerësohet në bazë të metodës së trekëndëshave të pagesave për produktet te departamentit motorik - përgjegjësi ndaj palëve te treta ("MTPL") dhe për linjat e tjera të biznesit aplikohet një metodologji e thjeshtëzuar në bazë të normës së primeve të fituara.

Këshilli Mbikëqyres konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet e ceduara tek risiguruesit janë paraqitur në mënyrë të drejtë, sidoqoftë detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare individuale në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

vi) Detyrimet e kushtëzuara për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve ndodhen në proces gjyqësor. Shoqëria ka regjistruar detyrime të përshtatshme të sigurimit bazuar në vlerësimin e drejtimit të cilat paraqiten në shënimin 31.

vii) Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun duke zvogëluar kështu potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linja e biznesit të MTPL-së dhe aksidenteve përfshirë këtu kartonin jeshil, sigurimin e pasurisë, marinës dhe aviacionit, detyrime civile dhe të tjera gjithashtu dhe linja të tjera biznesi.

Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshje të tejkalimit të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe kohës regjistrohen si aktive risigurimi. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur afati i tyre mbaron.

Primet e risiguruara ose primet e ceduara tek risiguruesit njihen si shpenzime në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për aktivitetin e përgjithshëm të sigurimit, primet e risigurimit njihen si shpenzime në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi. Shuma e njohur si aktive të risigurimit matet në mënyrë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur për kontratat lidhura të sigurimit.

Aktivet nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit në lidhje me primet e ceduara tek risiguruesit dhe arkëtimet nga shoqëria risiguroese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si aktive nga risigurimi dhe paraqiten të veçanta, nëse ka. Aktivet nga risigurimi vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos arkëtojë të gjitha shumat dhe ngjarja ka një ndikim të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

viii) Shpenzimet e trajtimit të dëmeve

Shpenzimet e trajtimit të dëmeve përbëhen nga shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet e brendshme të trajtimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë jo të rëndësishme në krahasim me shpenzimet e jashtme. Shoqëria krijon një provizion për shpenzimet e trajtimit të dëmeve brenda provizioneve përkatëse të trajtimit të dëmeve, i cili përfshihet në detyrimet nga kontratat e sigurimit lidhur me dëmet.

Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Shoqërisë maten me kosto të amortizuar. Aktivet financiare janë të klasifikuara në hua dhe llogari të arkëtueshme. Shoqëria klasifikon detyrimet financiare jo-derivative në detyrime të tjera financiare.

Njohja. Instrumentet financiare të Shoqërisë (aktivet dhe detyrimet) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera të vëzhgueshme aktuale të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Klasifikimi. Aktivet financiare të Shoqërisë klasifikohen në depozita dhe llogari të arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit janë aktive të sigurimit. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare nuk klasifikohen si të mbajtura deri në maturim pasi nuk ka treg aktiv për këto letra dhe për rrjedhojë ato përmbushin përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme. Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet nga kontratat e sigurimit dhe detyrimet të tjera) dhe llogariten kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të sigurimit janë aktive financiare jo-derivative të pakuotuar me pagesa fikse ose të përcaktueshme të ndryshme nga ato që Shoqëria synon të shesë në periudhën e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë **depozitat me afat pranë bankave, llogaritë e tjera të arkëtueshme, bono dhe obligacionet e thesarit** të emetuara nga Qeveria Shqiptare mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionin për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur aktivet riblihen ose të drejtat për flukset monetare nga aktivet skadojnë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale janë shlyer, anuluar ose skadojnë.

Matja e koston së amortizuar. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar njihet në njohjen fillestare minus çdo ripagim të kryegjësë, plus interesin e përlllogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo zhvlerësim për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose aktualizimi deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e përlllogaritura nga interesi dhe shpenzimet e përlllogaritura nga interesi, duke përfshirë kuponin e përlllogaritur dhe zbritjen ose primin e amortizuar (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kompensimi. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim që ose të shlyhet në bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme, për shembull në aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

Çvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me koston të amortizuar. Humbjet nga çvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin për shkak të një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarjeve të humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe që kanë një ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të aktivitetit financiar ose grupi i aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Shoqëria përcakton se nuk ekziston asnjë evidencë objektive që zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor dhe i vlerëson ato bashkarisht për zhvlerësim.

Faktorët kryesorë që Shoqëria merr në konsideratë në përcaktimin nëse një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë statusi i tij i vonuar, detyrimet që mund të kompensohen për të njëjtin klient dhe realizueshmëria e kolateralit të lidhur, nëse ka. Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi: any portion or instalment is overdue, and the late payment cannot be attributed to a delay caused by the settlement systems.

- çdo pagesë ose këst është vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga metoda e shlyerjes.
- pala tjetër ndodhet në një vështirësi të konsiderueshme financiare siç vërtetohet nga informacioni financiar që merr Shoqëria.
- pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim të aktivitetit.
- ka një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së palës tjetër për shkak të ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë në palën tjetër; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, ulet ndjeshëm për shkak të përkeqësimit të kushteve të tregut.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, dhe depozitat me afat me bankat

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, depozitat me bankat dhe investime të tjeraafatshkurtra me likuiditet të lartë me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që inënshtrohen një rreziku të parëndësishëm ndryshimi në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Shoqëria në angazhimet e saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Depozitat me afat me bankat janë paraqitur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme, fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke zbritur humbjet nga çvlerësimi. Ato vlerësohen për çvlerësim në çdo datë raportimi

Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë zbritur koston e transaksionit të drejtpërdrejtë që të cilit i përkasin. Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Garancia për kartonin jeshil

Një nga linjat e biznesit të Shoqërisë është sigurimi i kartonit jeshil. Në datën e raportimit, Shqipëria është nën monitorimin e Byrosë Ndërkombëtare të Sigurimeve në lidhje me aftësinë e aktorëve të saj në tregun e sigurimeve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga sigurimi i kartonit jeshil. Në këtë masë, Byroja Ndërkombëtare kërkoi kundrejt Byrosë Shqiptare të Sigurimeve të depozitonte një garanci në favor të saj, e cila mund të përdoret nëse një nga shoqëritë shqiptare të sigurimeve nuk arrin të përmbushë detyrimet e sigurimit të kartonit jeshil. Prandaj, shoqëria ka kontribuar në bazë të pjesës së saj të sigurimit të kartonit jeshil në depozitën e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Kontributi njihet nga Shoqëria si garanci në aktive të tjera pasi i paguhet Byrosë Shqiptare të Sigurimeve.

Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar (shënim 15) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto përfshin shpenzimet që i takojnë drejtpërdrejt koston së blerjes së aktivitetit. Kur pjesët e një aktivi kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (pjesë përbërëse kryesore) të pajisjes.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të pajisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të ndërtesës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**Zhvlerësimi**

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i përmirësimeve të objekteve me qira realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa vlerësimi i aktiveve të tjera aftagjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria	2024	2023
Ndërtesa	2.50%	2.50%
Mjete motorike	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe zyre	20%-25%	20%-25%

Vlera e mbetur nëse nuk është materiale rivlerësohet çdo vit. Përmirësimet e qirasë kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës më të vogël të jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë.

Metodat e amortizimit dhe jetëgjatësia e dobishme rivlerësohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi..

Aktive me të drejtë përdorimi

Shoqëria jep me qira zyra të ndryshme. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Për qiratë e pasurive të paluajtshme për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, Shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë dhe në vend të kësaj i llogarit si një përbërës të vetëm qiraje.

Aktivitet me të drejtë përdorimi që lindin nga një qira, fillimisht maten mbi bazën e vlerës aktuale (detyrimi i qirasë).

Aktivitet me të drejtë e përdorimit maten me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë. Këto aktive në përgjithësi amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivitet dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është e sigurtë se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të parashikuar të ndërtesave prej 10 vitesh..

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot e lidhura me emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si pakësim, neto nga tatimi mbi fitimin. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar

Rezerva për veprimtarinë e sigurimit

Rezerva për veprimtarinë e sigurimit është krijuar në bazë të nenit 93 të Ligjit të mëparshëm për aktivitetin e shoqërive të sigurimit. Rezerva akumulohet çdo vit bazuar në një të tretën e fitimit të periudhës së mëparshme nëse fitimi nuk përdoret për të mbuluar humbjet e mbartura të mëparshme. Kjo rezervë është krijuar për të garantuar fondin e aftësisë paguese dhe të garancisë dhe nuk mund të përdoret nga Shoqëria për qëllime të tjera. Rezerva nuk është akumuluar më që nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri të Sigurimeve në 2014. Shoqëria është e përjashtuar nga rezerva ligjore sipas kërkesës së Ligjit për Shoqëritë Tregtare në përputhje me nenin 9 të ligjit aktual për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve..

Detyrime qiraje

Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave fikse (duke përfshirë pagesat fikse).

Mundësitë e zgjatjes dhe përfundimit të qirasë përfshihen në disa kontrata qiraje të pronave. Këto terma përdoren për të rritur fleksibilitetin shfrytëzues për administrimin e aseteve të përdorura në veprimtarinë e Shoqërisë. Mundësitë e zgjatjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme si nga Shoqëria ashtu edhe nga qiradhënësi përkatës. Opsionet e zgjatjes (ose opsionet e periudhës pas përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë) sipas vendimit të Shoqërisë. Pagesat e qirasë që do të ndodhin sipas opsioneve të arsyeshme të zgjatjes përfshihen gjithashtu në matjen e detyrimit. Pagesat e qirasë skontojnë duke përdorur normën e interesit të përfshirë në qira.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Meqenëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, gjë që ndodh në përgjithësi për qiratë e Shoqërisë përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, duke qenë norma që Shoqëria duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të siguruar një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin me të drejtë përdorimi në një mjedis të ngjashëm ekonomik me përcaktime, kolateral dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën në rritje të huamarrjes, Shoqëria i referohet normës që është në dispozicion të Uniqa Group e cila:

- përdor një qasje rritëse që fillon me një normë interesi pa rrezik të rregulluar për rrezikun kreditor, dhe
- bën rregullime specifike të qirasë, p.sh., afatin, vendin, monedhën dhe kolateralin.

Pagesat për qiratë afatshkurtra të pajisjeve dhe automjeteve dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.

Provizionet për detyrimet dhe tarifat

Provizionet për detyrimet dhe tarifat janë detyrime jofinanciare në kohë ose vlerë të papërcaktuar. Provizionet përlogariten kur Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për shkak të ngjarjeve të ndodhura më parë, dhe përfitime ekonomike të kërkohen për të shlyer detyrimin pas një vlerësimi të shumës së detyrimit. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të afatit kohor njihet si shpenzim interesi në shpenzimet financiare.

Taksat dhe tarifat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore bazuar në informacionin që lidhet me një periudhë përpara se të lindte detyrimi për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Taksat dhe tarifat, përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si një parapagim. Ndër të tjera, mbi të njëjtën bazë, Shoqëria krijon provizion për fondin e kompensimit të sigurimit motorik, i cili ndahet nga AMF për të gjitha shoqëritë e sigurimit bazuar në peshën e tyre në tregun e sigurimit të mjeteve motorike.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përfshijnë komisionin e risigurimit, të njohur në shlyerjen nga risiguresit.

Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose humbje në datën e deklarimit të dividendit.

Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Pagat, kontributet e përfitimit të pensionit dhe fondet e sigurimeve shoqërore, pushimet vjetore të paguara dhe pushimet për arsye shëndetësore, shpërblimet dhe përfitimet jomonetare janë përlogaritur në vitin në të cilin shërbimet shoqërore kryhen nga punonjësit e Shoqërisë. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të bërë pagesa pensionesh ose përfitimesh të ngjashme përtej pagesave në skemën shtetërore dhe private të kontributeve të përcaktuara.

Qiratë operative

Kur Shoqëria është qiradhënëse në një qira e cila nuk i transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë të qiramarrësit (qiraja operative), pagesat e qirasë njihen si të ardhura të tjera në bazë lineare.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Tatim mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë, i cili njihet në fitim ose humbje.

Tatimi aktual përfshin tatimin e pritshëm të pagueshëm ose të arkëtueshëm mbi të ardhurat e tatueshme dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose merret që pasqyron pasigurinë në lidhje me tatimin mbi fitimin, nëse ka. Aktivet dhe detyrimet aktuale të tatimit mbi fitimin kompensohen.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë pasqyron efektet tatimore që do të pasonin nga mënyra në të cilën Shoqëria pret që në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivitativ i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyrë vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe parashikime që lidhur me vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare individuale dhe në vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme. Përveç vlerësimeve, drejtimi gjithashtu bën disa gjykime lidhur me procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që lind nga pretendimet e bëra në bazë të kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më domethënës i Shoqërisë. Vendimet e Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe përcaktimi i provizioneve dhe vlerave të rikuperueshme nga risigurimet përkatëse rishikohen dhe përditësohen çdo vit. Rregullimet që rezultojnë nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje. Kjo procedurë supozon se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencave të mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen teste për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të dëmeve. Testet primare të kryera janë analiza "Raporti i dëmeve" dhe analiza "Run-off" e rezervave të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht në linjat kryesore të biznesit. Llogaritja kryhet për dëmet veçmas, si dhe për dëmet që përfshijnë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe çdo shpenzim tjetër të trajtimit të dëmeve. Në kryerjen e kësaj analize, Shoqëria merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse monetare. Shoqëria nuk i aktualizon këto flukse monetare të vlerësuara sepse shumica e dëmeve priten dhe kërkohen të shlyhen brenda një viti.

Përveç kësaj, Shoqëria kryen një analizë të zhvillimit të rezervave të dëmeve çdo vit për të vlerësuar metodologjinë e saj të rezervimit. Analiza kryhet individualisht mbi dëmet e raportuara por të papaguara ("RBNS") dhe dëmet e ndodhura por të paraportuara ("IBNR"), si dhe një analizë të kombinuar (shënimi 18). Në rast se analiza ka mospërputhje të mëdha, rregullimet e duhura bëhen në metodologjinë e rezervimit. Nëse identifikohet një mangësi, kjo raportohet në fitim ose humbje duke krijuar një provizion rreziku të paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve, një test shtesë i mjaftueshmërisë së detyrimit i kryer për UPR që përfaqëson llogaritjen e rezervës së riskut të paskaduar (URR). Kjo rezervë llogaritet në baza tremujore nga aktuarët e Shoqërisë.

3. Vlerësime dh gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Treguesi kryesor i përdorur është raporti i kombinuar (raporti i shumës së dëmit dhe shpenzimeve). Nëse vlera e raportit të kombinuar është nën 100%, UPR mund të konsiderohet si e mjaftueshme. Në rast se raporti i kombinuar është më i madh se 100%, atëherë URR do të llogaritet dhe do të rezervohet për të plotësuar mungesën e UPR.

Kjo analizë, duke përfshirë ndjeshmërinë ndaj supozimeve kryesore, është përfshirë në këto pasqyra financiare në shënimin 5, administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit.

Detyrimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor. Ndërsa drejtimi konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe dëmet e paguara nga risiguruesit, duke përfshirë rezervat dhe kushtëzimet për dëmet sipas një procesi ligjor, janë deklaruar në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme të shumave të ofruara. Rregullimet në shumat e detyrimeve të sigurimit pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën janë bërë rregullimet. Administrimi i rrezikut të sigurimit detajohet në shënimin 5, ndërsa dispozitat e kontratave të sigurimit janë analizuar në shënimin 18. Kushtëzimet në lidhje me dëmet në proces gjyqësor janë paraqitur në shënimin 31.

4. Shpallje të reja të kontabilitetit

Shoqëria pritet të adoptojë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) duke filluar nga 1 janari 2025. SNRF 1 do të zbatohet gjatë këtij adoptimi, me periudhat krahasuese që do të rishikohen në përputhje me këtë standard.

5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit

Shoqëria pranon rrezikun e sigurimit nëpërmjet kontratave të sigurimit ku merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose shoqëritë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurive lidhur me kohën, shpeshtësinë dhe madhësinë e dëmeve sipas këtyre kontratave.

Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e biznesit. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të normave të primit të sigurimeve dhe përshtatshmërinë e provizioneve në lidhje me detyrimet që lidhen me kontratat e sigurimeve dhe bazën e kapitalit. Rreziku i primit është i pranishëm kur polica lëshohet përpara se një ngjarje e siguar të ketë ndodhur. Rreziku nënkupton rastin kur shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara janë më të larta se shumat e pranuar. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provizioneve teknike ose pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës së mesatares statistikore.

Administrimi i rreziqeve

Shoqëria administron rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së saj të planit të risigurimit brenda një kuadri tëpërgjithshëm të administrimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozime që kanë të bëjnë me ecurinë dhe përvojën mëparshme. Ekspozimet ndaj rreziqeve administrohen përmes kufizimeve dhe kriterëve të vendosura kontratat e nënshkruara.

Risigurimi minimizon efektin e humbjes potenciale ndaj Shoqërisë nga ngjarje të mëdha ose katastrofike dhe gjithashtu ndikon në aksesin e specialistëve ndaj rreziqeve dhe lehtëson administrimin e kapitalit. Politikat e risigurimit janë të dakordësuara me risiguruesit e aprovuar, të kuotuar ose bazohen në terma të limiteve të marrëveshjes për kufijtë e humbjeve. Kapitali rregullator administrohet duke iu referuar rrezikut të sigurimit në të cilin është ekspozuar Shoqëria.

Shoqëria ka marrëveshje risigurimi për të siguar mbrojtjen ndaj rreziqeve që lidhen me pasuritë dhe përgjegjësitë dhe mjetet motorike kryesisht për një kohëzgjatje 12-mujore. Rreziqet më të rëndësishme lindin nga fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe katastrofat e tjera (dëme të mëdha, ngjarje me shpeshtësi të ulët). Një përqendrim rreziku mund të lindë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar për një tip të veçantë demografik të policë-mbajtësit, brenda një hapësire gjeografike ose në llojet e biznesit. Ndryshueshmëria relative e rezultatit minimizohet nëse ka një portofol të konsiderueshëm me rreziqe të ngjashme.

5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Provizionet e rezervës së dëmeve sipas llojit të kontratës detajohet si më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

Linja e biznesit	Bruto	2024		Bruto	2023	
		Risigurimi	Neto		Risigurimi	Neto
Mjete motorike	2,705,394	(202,974)	2,502,420	2,420,827	(209,064)	2,211,763
Prona	883,033	(531,402)	351,631	713,549	(385,354)	328,195
Shëndeti dhe aksidentet	43,482	-	43,482	50,823	-	50,823
Totali	3,631,909	(734,376)	2,897,533	3,185,199	(594,418)	2,590,781

Provizionet e rezervës së primit të pafitur sipas llojit të kontratës përmbledhet më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

Linja e biznesit	Bruto	2024		Bruto	2023	
		Risigurimi	Neto		Risigurimi	Neto
Mjete motorike	1,701,208	-	1,701,208	1,593,109	(41)	1,593,068
Prona	933,476	(282,997)	650,479	819,039	(217,016)	602,023
Shëndeti dhe aksidentet	310,675	(11,028)	299,647	251,805	(16,231)	235,574
Totali	2,945,359	(294,025)	2,651,334	2,663,953	(233,288)	2,430,665

Dëmet e ndodhura krahasuar me parashikimet

Provizioni për koston përfundimtare të pritshme të shlyerjes së të gjitha pretendimeve të ndodhura në lidhje me ngjarjet deri në atë datë, pavarësisht nëse janë raportuar apo jo, së bashku me shpenzimet e trajtimit të dëmeve, minus shumat e paguara janë bërë në datën e raportimit.

Detyrimi për dëmet e raportuara (RBNS) vlerësohet në baza të veçanta rast pas rasti duke u bazuar te rrethanat e dëmeve, informacionin në dispozicion për pritshmërinë e humbjes dhe evidencave historike të rasteve të ngjashme. Rezervat e dëmeve pezull rishikohen rregullisht dhe përditësohen në bazë të informacionit të ri.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të paraportuara (IBNR) në përgjithësi është subjekt i një shkalle më të madhe pasigurie se sa dëmet e raportuara. Provizionet e IBNR vlerësohen kryesisht nga aktuarë të Shoqërisë duke përdorur teknika statistikore, ku të dhënat historike nxirren për të llogaritur kostot përfundimtare të pretendimeve.

Për aq kohë që këto metoda përdorin informacione historike të zhvillimit të pretendimeve për dëme mendohet se modeli historik i zhvillimi do të përsëritet në të ardhmen. Ka arsye pse ky nuk mund të jetë rasti, i cili, për aq sa ato mund të identifikohen, janë të lejuara për të modifikuar metodat. Arsye të tilla përfshijnë :

- tendencat ekonomike, ligjore, politike dhe sociale ekonomike (duke rezultuar në nivele të ndryshme të inflacionit nga ato të pritshme);
- ndryshimet në kontratat e sigurimit të krijuara;
- luhatjet e rastit, duke përfshirë ndikimin e humbjeve të mëdha.

Provizionet e IBNR vlerësohen fillimisht në një nivel bruto dhe një llogaritje e veçantë është kryer për të vlerësuar arkëtimet nga risigurimi.

5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të ndodhura të krahasuara me vlerësimet e mëparshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 që nga viti 2019. Ato nuk përfshijnë shpenzimet për trajtimin e dëmeve dhe rrjedhimisht ndryshon me shënimin 18.

	2024	2023	2022	2021	2020	2019
RBNS						
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit	1,822,950	1,732,429	1,956,213	2,635,617	1,562,151	1,480,768
Dëmet e periudhave të mëparshme të paguara gjatë vitit	(689,184)	(460,200)	(771,530)	(913,512)	(879,443)	(447,728)
Vlerësimet në fund të vitit për dëme të periudhave të mëparshme	(1,460,210)	(1,215,272)	(1,148,024)	(1,531,464)	(897,123)	(1,118,493)
Shmangia në Lekë '000	(326,444)	56,957	36,659	190,641	(214,415)	(85,453)
Shmangia në %	(17.91)%	3.29%	3.44%	1.87%	7.23%	(13.73)%
IBNR						
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit	1,320,261	1,161,663	1,057,244	928,991	1,080,914	689,691
Dëmet e periudhave të mëparshme të paguara gjatë vitit	(180,090)	(316,035)	(556,168)	(360,466)	(440,586)	(409,646)
Vlerësimet në fund të vitit për dëme të periudhave të mëparshme	(1,084,204)	(836,423)	(660,237)	(781,449)	(570,042)	(396,919)
Shmangia në Lekë '000	55,967	9,205	(159,161)	(212,924)	70,286	(116,874)
Shmangia në %	4.24%	0.79%	(15.05)%	(22.92)%	6.50%	(16.95)%

	2024	2023	2022	2021	2020	2019
Detyrimet nga kontratat e sigurimit - dëmet						
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit	3,143,211	2,894,092	2,848,040	2,885,204	3,716,530	2,251,842
Dëme të paguara dhe të raportuara gjatë periudhës	(869,273)	(776,235)	(1,183,351)	(1,131,996)	(1,354,098)	(1,289,089)
Vlerësimet në fund të vitit për dëmet	(2,544,414)	(2,051,695)	(1,762,330)	(1,929,473)	(2,101,506)	(1,294,042)
Shmangia në Lekë '000	(270,476)	66,162	(97,641)	(176,265)	260,926	(331,289)
Shmangia në %	(8.61)%	2.29%	(3.43)%	(6.11)%	7.02%	(14.71)%

Drejtimi rishikon vlerësimet dhe supozimet e dëmeve bazuar në zhvillimin aktual të dëmeve dhe bën rregullimet e duhura për metodologjitë e dëmeve.

Tabela e mëposhtme tregon zhvillimin gradual të vlerësimit të humbjes përfundimtare sipas dëmeve të ndodhura gjatë vitit. Vlerësimi pësoi ndryshime në periudha individuale në varësi të dëmeve aktuale të paguara. Krahasimi i vlerësimit statistikor të provizioneve të mjaftueshme me shumën bruto të provizioneve sugjeron nivele të mjaftueshme të provizioneve për dëme duke përfshirë dëmet e ndodhura por të paraportuara.

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.

Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Periudha e kontabilizimit	2017 dhe më herët	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Total
Vlerësimi i shpenzimeve përfundimtare për dëmet									
Në fund të periudhës raportuese	61,513,112	1,172,869	2,772,834	1,079,702	1,503,837	1,520,946	1,699,932	2,219,692	
Një vit më vonë	11,098,397	1,444,673	2,860,745	1,108,004	1,953,990	1,606,001	1,985,907	-	
Dy vite më vonë	11,157,882	1,470,123	2,947,652	1,003,750	1,815,269	1,519,850	-	-	
Tre vite më vonë	11,083,594	1,453,891	2,851,485	1,033,252	1,813,367	-	-	-	
Katër vite më vonë	11,160,883	1,436,692	2,844,137	934,741	-	-	-	-	
Pesë vite më vonë	11,025,991	1,360,607	-	-	-	-	-	-	
Gjashtë vite më vonë	11,067,424	1,382,958	-	-	-	-	-	-	
Shtatë vite më vonë	11,167,381	-	-	-	-	-	-	-	
Vlerësimi aktual i shpenzimeve kumulative të dëmeve	11,167,381	1,382,958	2,892,893	934,741	1,813,367	1,519,850	1,985,907	2,219,692	23,916,789
Paguesat kumulative për dëme	10,567,466	1,246,409	2,680,036	806,189	1,479,192	1,141,944	1,231,448	1,172,775	20,325,459
Detyrimet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar	599,915	136,549	212,857	128,552	334,176	377,906	754,460	1,046,917	3,591,332

Krahasimi i vlerësimit statistikor të provizioneve të mjaftueshme me shumën neto të provizioneve sugjeron nivele të mjaftueshme të provizioneve për dëme duke përfshirë dëmet e ndodhura por të paraportuara.

Periudha e kontabilizimit	2016 dhe më herët	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total
Vlerësimi i shpenzimeve përfundimtare për dëmet									
Në fund të periudhës raportuese	50,510,116	1,612,848	1,172,869	2,772,834	1,079,702	1,503,837	1,520,946	1,699,932	
Një vit më vonë	9,390,148	1,548,703	1,444,673	2,860,745	1,108,004	1,953,990	1,606,001	-	
Dy vite më vonë	9,549,694	1,569,019	1,470,123	2,947,652	1,003,750	1,815,269	-	-	
Tre vite më vonë	9,588,863	1,558,552	1,453,891	2,851,485	1,033,252	-	-	-	
Katër vite më vonë	9,525,041	1,652,085	1,436,692	2,844,137	-	-	-	-	
Pesë vite më vonë	9,508,798	1,593,352	1,360,607	-	-	-	-	-	
Gjashtë vite më vonë	9,432,639	1,583,812	-	-	-	-	-	-	
Shtatë vite më vonë	9,483,612	-	-	-	-	-	-	-	
Vlerësimi aktual i shpenzimeve kumulative të dëmeve	9,483,612	1,583,812	1,360,607	2,844,137	1,033,252	1,815,269	1,606,001	1,699,932	21,426,622
Paguesat kumulative për dëme	9,090,772	1,471,079	1,246,010	2,515,350	787,305	1,378,547	1,020,261	774,086	18,283,410
Detyrimet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar	392,840	112,733	114,597	328,787	245,947	436,722	585,740	925,846	3,143,211

5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Supozimet e mëposhtme kanë efektin më të madh në llogaritjen e detyrimeve të kontratave të sigurimit:

Raporti i dëmeve të pritshme. Raporti i dëmeve të pritshme paraqet raportin e dëmeve të paguara dhe dëmeve që mund të ndodhin ndaj primeve të fituara duke përjashtuar pjesën e risiguruesit dhe dëmeve të paguara dhe ndryshimet e pritshme (në RBNS dhe IBNR). Supozimet lidhur me raportin e dëmeve të pritshme për aksidentet të ndodhura gjatë viteve të fundit për linjat e biznesit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provizioneve.

Faktorë pasues. Për bizneset me cikël të gjatë kohor, niveli i provizionit është ndikuar ndjeshëm nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve të ndodhura gjatë vitit të fundit për të cilat të dhënat historike janë në dispozicion. Këta faktorë pasues vlerësohen bazuar në përvojën e kaluar.

Aktualizimet. Dëmet për aktivitetin e sigurimit të jo-jetës nuk aktualizohen.

Zhvillimi i dëmit. Dëmet e ndodhura shqyrtohen përgjithësisht brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe mbyllen zakonisht brenda një viti. Dëmet nga kartoni jeshil kanë një periudhë shqyrtimi më të gjatë e megjithatë jo më të gjatë sesa mbi një vit. Nga përvoja e Shoqërisë, në përfundim të shqyrtimi i dëmeve nuk ka ndryshime materiale nga vlerësimet paraprake.

Supozimet dhe ndjeshmëria. Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri treguesish që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Marrëveshjet e risigurimit të Shoqërisë përfshijnë pjesën e kuotës, tejkalimin e nivelit të humbjeve ose mbulimin nga ngjarje katastrofike. Efekti i një marrëveshjeje të tillë risigurimi kufizon humbjet neto të sigurimit ose mbajtjen e Shoqërisë në limite 250 - 500 mijë Euro në çdo vit të caktuar, për çdo linjë biznesi MTPL dhe pasuri. Linjat e tjera të biznesit kanë ekspozime më të ulëta ndaj rrezikut. Përveç programit të përgjithshëm të risigurimit të Shoqërisë, klientët mund të jenë pjesë e një mbrojtjeje shtesë risigurimi, i quajtur risigurim fakultativ.

Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrat e pozicionit financiar për qëllime të veçanta. Megjithatë, përvoja aktuale mund të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

	2024	2023
Raporti i dëmeve	(43.9%)	(35.6%)
Raporti i shpenzimeve	(49.5%)	(49.9%)
Raporti i kombinuar	(93.4%)	(85.5%)

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten si më poshtë: Për këtë lloj ndjeshmërie tregohet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Impakti	2024	Impakti	2023
Raporti i dëmeve				
10% rritje	Humbje	(203,191)	Humbje	(156,589)
10% zbritje	Fitim	203,191	Fitim	156,589
Raporti i shpenzimeve				
10% rritje	Humbje	(229,060)	Humbje	(219,422)
10% zbritje	Fitim	229,060	Fitim	219,422
Raporti i kombinuar				
10% rritje	Humbje	(432,251)	Humbje	(376,011)
10% zbritje	Fitim	432,251	Fitim	376,011

6. Administrimi i rrezikut financiar

Funksioni i administrimit të rrezikut në Shoqëri kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operacionale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivi kryesor i funksionit të administrimit të rrezikut financiar është të përcaktojë kufijtë e rrezikut, dhe pastaj të sigurojë që ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet operative dhe ligjore të administrimit të rrezikut kanë për qëllim sigurimin e funksionimit të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Shoqëria nuk përdor instrumentet financiare derivative për t'u mbrojtur nga këto ekspozime ndaj rreziqeve.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje të rrezikut:

- Rreziku valutor - rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit;
- Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit-rreziku që vlera e një instrumenti financiar të ndryshojë për shkak të luhatjes së normave të interesit të tregut;
- Rreziku i çmimit - rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, pavarësisht nëse këto ndryshime shkaktohen nga faktorë specifikë të lidhur me instrumentin ose emetuesin e tij apo faktorë që prekin të gjithë instrumentet që janë të tregëtueshëm në treg.

Rreziku i tregut përfaqëson jo vetëm mundësinë e humbjes por edhe për të fituar.

Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet mbi baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i parandalon humbjet jashtë këtyre limiteve, në rast të luhatjeve të konsiderueshme të tregut.

Ndjeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut të dhëna në vijim bazohen në ndryshimin e një faktori duke mbajtur faktorët e tjerë konstantë. Në praktikë kjo ka shumë pak mundësi të ndodhë dhe ndryshimet në disa prej faktorëve mund të jenë të ndërlidhur për shembull ndryshimet në normat e interesit dhe ndryshimet në kurset e këmbimit.

Rreziku valutor

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe rreziku nga luhatjet e kurseve të këmbimit është i pranishëm. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë në nivelin e kapitalit të aksionarëve pas përkthimit të tij në monedhën lokale. Rreziku valutor në portofolin e investimeve administrohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare të aplikueshme (Lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
USD	94.26	93.94
CHF	104.27	112.10
EUR	98.15	103.88

Shoqëria nënshkruan policat në Lekë, Euro ose USD. Shoqëria hyn në marrëveshjet e risigurimit kryesisht në Euro, blen mallra dhe shërbime në Euro dhe Lekë ose USD. Sigurimet dhe dëmet dhe rezervat kryhen kryesisht në monedhën që polica është nënshkruar. Për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor.

Politikat dhe procedurat e Shoqërisë fokusohen në minimizimin e rrezikut valutor duke balancuar shumën e mjeteve monetare të përdorura në secilën monedhë, kryesisht duke investuar në depozita me afat për të përshtatur detyrimet që rezultojnë në monedhën përkatëse.

Sigal Uniq Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë në monedha të huaja më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

Në Lekë '000	Lekë	EUR	USD	CHF	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	50,890	45,769	8,586	17	105,262
Depozita me afat me bankat	1,813,483	3,271,803	473,221	-	5,558,507
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	60,000	640,117	-	-	700,117
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	112,639	305,969	20,133	-	438,741
Aktive të risigurimit	72,283	922,075	34,043	-	1,028,401
Borxh i varur për filiale	-	104,317	-	-	104,317
Aktive të tjera	12,199	6,410	-	-	18,609
Aktive financiare	2,121,494	5,296,460	535,983	17	7,953,954
Detyrimet nga kontrata e sigurimit (duke përfshirë UPR)	(4,348,945)	(2,154,866)	(73,057)	(400)	(6,577,268)
Detyrim qiraje	(75,258)	-	-	-	(75,258)
Detyrime të tjera	(204,885)	(126,451)	(8,692)	-	(340,028)
Detyrime financiare	(4,629,088)	(2,281,317)	(81,749)	(400)	(6,992,554)
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(2,507,594)	3,015,143	454,234	(383)	961,400

Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë në monedha të huaja më 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

Në Lekë '000	Lekë	EUR	USD	CHF	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	47,940	73,418	6,085	53	127,496
Depozita me afat me bankat	1,455,770	3,348,838	434,550	-	5,239,158
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	-	624,830	-	-	624,830
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	136,693	258,644	14,820	-	410,157
Aktive të risigurimit	79,078	716,859	31,769	-	827,706
Borxh i varur për filiale	-	108,536	-	-	108,536
Aktive të tjera	8,441	9,281	-	-	17,722
Aktive financiare	1,727,922	5,140,406	487,224	53	7,355,605
Detyrimet nga kontrata e sigurimit (duke përfshirë UPR)	(3,816,886)	(1,986,299)	(45,429)	(538)	(5,849,152)
Detyrim qiraje	(125,977)	-	-	-	(125,977)
Detyrime të tjera	(237,689)	(139,389)	(9,657)	-	(386,735)
Detyrimet financiare	(4,180,552)	(2,125,688)	(55,086)	(538)	(6,361,864)
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(2,452,630)	3,014,718	432,138	(485)	993,741

Ndjeshmëria ndaj rrezikut të luhatjeve të monedhave të huaja

Tabela e mëposhtme detajon ndjeshmërinë e Shoqërisë në fitim/humbje pas tatimit, për ndikimin në vlerën Lekut shqiptar kundrejt monedhave të tjera. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret për raportimet e brendshme të rrezikut nga kurset e këmbimit dhe përfaqëson vlerësimin e drejtimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Më poshtë paraqitet impakti i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar

Sigal Uniq Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2024:

	Impakti	Shuma
EUR rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitim	301,514
EUR ulet me 10% kundrejt Lekut	Humbje	(301,514)
USD rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitim	45,423
USD ulet me 10% kundrejt Lekut	Humbje	(45,423)

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2023:

	Impakti	Shuma
EUR rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitim	301,472
EUR ulet me 10% kundrejt Lekut	Humbje	(301,472)
USD rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitim	43,214
USD ulet me 10% kundrejt Lekut	Humbje	(43,214)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e aktiveve me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre aktiveve. Kohës gjatë së cilës norma e interesit është fikse për një instrument financiar kushtëzon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesi

31 dhjetor 2024	Deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Jo të ndjeshme ndaj interesit	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	105,262	105,262
Depozita me afat me bankat	1,759,667	1,541,344	2,257,496	-	5,558,507
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	60,000	-	640,117	-	700,117
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	-	438,741	438,741
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	-	-	-	1,028,401	1,028,401
Borxh i varur për filiale	-	-	-	37,343	37,343
Aktive të risigurimit	-	-	104,317	-	104,317
Aktive të tjera	-	-	-	18,609	18,609
Aktive financiare	1,819,667	1,541,344	3,001,930	1,628,356	7,991,297
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëmet	-	-	-	(6,577,268)	(6,577,268)
Detyrim qiraje	-	-	-	(75,258)	(75,258)
Detyrime të tjera	-	-	-	(340,028)	(340,028)
Detyrime financiare	-	-	-	(6,992,555)	(6,992,555)
Pozicioni neto	1,819,667	1,541,344	3,001,930	(5,364,198)	998,743

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2023	Deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Jo të ndjeshme ndaj interesit	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	127,496	127,496
Depozita me afat me bankat	1,977,443	806,493	2,071,905	383,317	5,239,158
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	624,830	-	-	-	624,830
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	-	410,157	410,157
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	-	-	-	827,706	827,706
Borxh i varur për filiale	-	-	-	34,654	34,654
Aktive të risigurimit	-	-	-	108,537	108,536
Aktive të tjera	-	-	-	17,722	17,722
Aktive financiare	2,602,273	806,493	2,071,905	1,909,589	7,390,260
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëmet	-	-	-	(5,849,151)	(5,849,152)
Detyrim qiraje	-	-	-	(125,977)	(125,977)
Detyrime të tjera	-	-	-	(386,735)	(386,735)
Detyrimet financiare	-	-	-	(6,361,863)	(6,361,863)
Pozicioni neto	2,602,273	806,493	2,071,905	(4,452,276)	1,028,397

Rreziku kreditor

Rreziku i kreditorit referohet rrezikut kur njëra palë mund t'i shkaktojë humbje financiare palës tjetër duke mos realizuar shlyerjen e një detyrimi. Përgjatë rrjedhës normale të aktivitetit të biznesit, shumat e arkëtuara nga shitja e primeve investohen për të shlyer detyrimet e ardhshme të policave. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, depozitat me afat, të sigurimit dhe llogaritë e arkëtueshme të veprimtarisë së sigurimit.

Shoqëria ka procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave shoqëritë partnere të risigurimit duhet të kenë vlerësime BB- ose më të larta dhe rreziku monitorohet nga departamenti i risigurimit. Shoqëria administron ekspozimin ndaj rrezikut kreditor në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj borxhit dhe të vlerësimit të institucioneve bankare dhe nuk përqendron në çdo njërin prej tyre më shumë se 25%. Përqendrimi i investimeve është i bazuar në performancën financiare të institucioneve ashtu siç publikohet nga rregullatorët. Shoqëria investon vetëm në bankat që operojnë në Shqipëri dhe veprimtaria e të cilave rregullohet nga Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket llogarive të arkëtueshme, Shoqëria monitoron ditët e kaluara nga afati i shlyerjes. Në momentin që vonesat identifikohen, organizmat e monitorimit të rrezikut kreditor të Shoqërisë kontaktojnë klientët për të kuptuar arsyet e vonesës. Në rast të mos efikasitetit të kontakteve fillestare, Shoqëria identifikon të gjitha marrëdhëniet me klientët, në mënyrë që të marrë masat e duhura për të shmangur rrezikun kreditor duke përfshirë edhe telefonatat me palën tjetër, identifikimin e detyrimeve të palës tjetër në mënyrë që të arrihet një marrëveshje për kompensim.

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë sipas klasës së aktiveve është reflektuar në vlerat e aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre (përfshijtur mjete monetare në arkë)	8	104,698	126,816
Depozita me afat me bankat	9	5,558,507	5,239,158
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	10	700,117	624,830
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	11	37,343	34,654
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria sigurimit	12	438,741	410,157
Aktive të risigurimit	14	1,028,401	827,706
Borxh i varur për filiale	15,32	104,317	117,294
Aktive të tjera	17	18,609	17,722
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor		7,990,733	7,398,337

Asnjë tregues për çvlerësim nuk është identifikuar nga Shoqëria për aktivet e tjera financiare në datën e raportimit, prandaj drejtimi merr në konsideratë aktivet e tjera financiare si mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, depozitat me afat dhe aktivet e tjera si as në vonesë dhe as të çvlerësuar. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre, si dhe depozitat me afat janë vendosur në institucionet e mëposhtme financiare:

	Agjensia	Vlerësimi	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
			Ekspozimi total	Nga të cilat: Mjete monetare	Ekspozimi total	Nga të cilat: Mjete monetare
Banka Kombëtare Tregëtare	JCR					
	Eurasia	BB	1,878,604	15,857	1,791,796	25,414
Intesa San Paolo Bank	Moody's	Baa1	34,463	9,982	272,585	39,732
Raiffeisen Bank	Moody's	AA-	49,255	17,206	44,569	12,314
Credins Bank	Nuk ka	-	614,567	2,234	764,023	2,394
Banka Amerikane e Investimeve	Nuk ka	-	1,333,227	19,851	413,910	17,858
OTP Bank	Moody's	Baa1	468,432	14,265	581,423	14,254
ProCredit Bank	Fitch	BBB	89,517	4,183	169,706	3,361
Tirana Bank	Nuk ka	-	1,089,620	7,516	1,180,906	4,465
United Bank of Albania	Nuk ka	-	6,278	6,278	1,677	1,677
Union Bank	Nuk ka	-	42,503	4,410	96,507	2,880
First Investment Bank	Fitch	B	2,916	2,916	1,113	2,467
Totali i mjeteve monetare dhe depozitave me bankat			5,318,215	126,816	5,355,433	78,906

Bankat vendore të pavlerësuar i nënshtrohen rregulloreve të Bankës së Shqipërisë. Llogaritë në banka nuk janë të siguruara përveçse nga Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave. Duke qenë se pak banka shqiptare vlerësohen nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, Shoqëria përdor vlerësimet e kreditorëve të aksionerëve kryesorë të bankave për të marrë vendimet e saj për investime, si dhe raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë për bankat që operojnë në tregun shqiptar. Për bankat vendase që nuk vlerësohen, raportet e likuiditetit të Bankës së Shqipërisë nuk paraqesin probleme me pozicionin e tyre të likuiditetit.

Letrat me vlerë të investimit të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përbëhen nga investimi i Shoqërisë në Fondin e Investimeve WVP. Shoqëria ka investuar në indeksin WVP Global i cili përbëhet nga 30% indekse DJI dhe 70% Stoxx. Fondi WVP nuk është i vlerësuar, dhe operon me First Investment Bank si depozitar i saj (Fitch B).

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024**

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e risigurimit monitorohen sipas vlerësimit kreditor. Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 and 2023, vlerësimi i rrezikut kreditor për primet e ceduara tek risiguruesit dhe llogaritë e arkëtueshme nga risiguruesit sipas vlerësimit të risiguruesit (kërkesë nga legjislacioni lokal) janë si më poshtë:

Vlerësimi	2024				2023			
	Prime të ceduara		Aktive të risigurimit		Prime të ceduara		Aktive të risigurimit	
	Lekë '000	%	Lekë '000	%	Lekë '000	%	Lekë '000	%
A	689,089	78.0%	855,453	83.2%	753,422	77.9%	722,104	87.2%
BBB	169,021	19.1%	172,948	16.8%	171,791	17.8%	105,602	12.8%
BB	25,338	2.9%	-	-	41,606	4.3%	-	-
Totali	883,448	100%	1,028,401	100%	966,819	100%	827,706	100%

Cilësia e kreditimit të llogarive të arkëtueshmeve nga sigurimet është paraqitur në shënimin 12.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrimet financiare brenda periudhës kur ato duhet të shlyhen. Rreziku i likuiditetit është një rrezik i moderuar i brendshëm për aktivitetin e Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve mund të kenë karakteristika likuiditeti specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme parash brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje, duke qenë në bashkëpunim me të gjitha bankat e Shqipërisë, të cilat mund ti përdorë për të zgjidhur problemet afatshkurta të likuiditetit. Shoqëria administron rrezikun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të flukseve të parase së parashikuara dhe atyre aktuale, duke përputhur maturitetet mes aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2024 të detajuara sipas maturitetit të pritshëm (vetëm për detyrimet e kontratave të sigurimit) dhe maturitetit kontraktual paraqiten më poshtë: Shumat e detajuara më poshtë lidhen me maturimet kontraktuale, por në praktikë flukset hyrëse ose dalëse monetare nuk pritet të ndodhin në këto intervale.

31 dhjetor 2024	Deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 7 vite	Totali
Aktive				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	105,262	-	-	105,262
Depozita me afat me bankat	1,759,667	3,686,551	112,289	5,558,507
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	60,000	0	640,117	700,117
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	37,343	37,343
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	212,029	182,684	44,028	438,741
Aktive të risigurimit	117,889	270,233	640,279	1,028,401
Borxh i varur për filiale	-	-	104,317	104,317
Aktive të tjera	12,199	6,410	-	18,609
Aktive financiare	2,267,047	4,145,878	1,578,373	7,991,297
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëme	(1,321,490)	(2,418,672)	(2,837,107)	(6,577,268)
Detyrime qiraje	(9,719)	(29,157)	(36,382)	(75,258)
Detyrime të tjera	(190,416)	(131,160)	(18,452)	(340,028)
Detyrime financiare	(1,521,625)	(2,578,989)	(2,891,940)	(6,992,555)
Hendeku i ndjeshmërisë	745,422	1,566,889	(1,313,568)	998,743

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë deri më 31 dhjetor 2023 kanë maturimet e mëposhtme:

31 dhjetor 2023	Deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 7 vite	Totali
Aktive				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	127,496	-	-	127,496
Depozita me afat me bankat	1,672,895	3,182,946	383,317.20	5,239,158
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	624,830	-	-	624,830
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	34,654	34,654
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	207,788	165,419	36,518	409,725
Aktive të risigurimit	108,659	178,902	540,145	827,706
Borxh i varur për filiale	-	-	108,536	108,536
Aktive të tjera	8,441	9,281	-	17,722
Aktive financiare	2,750,108	3,536,548	1,103,170	7,389,826
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëme	(1,261,275)	(2,119,473)	(2,468,404)	(5,849,152)
Detyrime qiraje	(16,269)	(48,808)	(60,900)	(125,977)
Detyrime të tjera	(216,572)	(170,164)	0	(386,735)
Detyrime financiare	(1,494,117)	(2,338,444)	(2,529,304)	(6,361,865)
Hendeku i ndjeshmërisë	1,255,992	1,198,104	(1,426,135)	1,027,961

Në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë, të dhënë më sipër, janë paraqitur përkatësisht hyrjet dhe daljet e flukseve monetare të pritshme të paaktualizuara. Për sa i përket detyrimeve të kontratave të sigurimit, flukset dalëse të pritshme të paaktualizuara të mjeteve monetare janë paraqitur duke supozuar se periudha maksimale e detyrueshme e shlyerjes, sipas legjislacionit në fuqi, do të respektohet. Megjithatë, mund të ndodhin situata kur Shoqëria dhe paditësi nuk ndajnë të njëjtat pikëpamje në lidhje me vlerësimin e dëmit, mosmarrëveshja zgjidhet më tej përmes një procesi gjyqësor. Edhe pse në rastin e fundit zgjidhja shtyhet ndjeshëm, nuk është e mundur të bëhen parashikime të sakta.

7. Vlera e drejtë

Paraqitja e vlerës së drejtë për qëllime matjeje dhe/ose paraqitjeje analizohet sipas nivelit në hierarkik të vlerës së drejtë si më poshtë: (i) matjet e nivelit të parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive identike ose detyrime, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha të dhënat materiale të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë (si çmime) ose indirekte (që rrjedh nga çmimet), dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (pra matja kërkon hyrje të konsiderueshme të pakontrollueshme).

Drejtimi zbaton gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullime të rëndësishme, kjo matje është një matje e nivelit të tretë. Rëndësia e një treguesi vlerësohet kundrejt matjes së vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Shoqëria nuk ka aktive të cilat maten me vlerën e drejtë duke përdorur matje jo të përsëritura.

a) Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë

Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese.

Investimi i Shoqërisë në indeksin e investimeve WVP Global matet me vlerën e drejtë duke përdorur të dhëna të nivelit 1, i cili është i disponueshëm në wvpfunds.al (shënimi 11).

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***7. Vlera e drejtë (vazhdim)****b) Aktivët dhe detyrimet që nuk maten me vlerën e drejtë, por për të cilat paraqitet vlera e drejtë**

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe Depozita me afat me bankat- të cilat përfshijnë paratë në banka dhe depozitat me afat, përfshijnë transaksionet ndërbankare dhe para në proces arkëtimi. Duke qenë se depozitat janë afatshkurtra dhe me norma të luhatshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e afërt me vlerën e tyre kontabël

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit - për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër, vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit konsiderohet të jetë e përafërt me vlerën e tyre kontabël.

8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në arkë	564	680
Llogari rrjedhëse		
- Në lekë	50,327	47,940
- Në monedhë të huaj	54,371	78,876
	104,698	126,816
Totali	105,262	127,496

Cilësia e kreditimit të parave të gatshme në banka detajohet në shënimin 6.

9. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozita në bankë	4,764,682	4,451,398
Fondi i garancisë	740,000	740,000
Interesi i përlogaritur	53,825	47,760
Totali	5,558,507	5,239,158

Fondi i garancisë përbëhet nga depozita me afat me bankat tregtare. Fondi i garancisë mund të investohet vetëm nëpërmjet sistemit bankar në depozita afatgjata ose në bonot e thesarit dhe nuk është i disponueshëm për aktivitetet ditore dhe në bazë të kërkesave të legjislacionit vendor, Shoqëria mban një minimum prej një të tretës të nivelit të kërkuar të nivelit të aftësisë paguese, por jo më pak se 740 milionë lekë, në depozita me afat maturimi jo më pak se 1 vit. Më 31 dhjetor 2024, fondi i garancisë është 740,000 mijë lekë (2023: 740,000 mijë lekë). Depozitat me afat me bankat përbëhen nga depozitat në lekë dhe në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2024 and 2023:

	2024	Norma e interesit në %	2023	Norma e interesit në %
Në EUR	3,174,267	1.40 – 3.00	3,311,932	1.10 – 3.00
Në USD	469,415	1.70 – 2.50	431,466	1.50 – 2.60
Në ALL	1,861,000	1.90 – 3.00	1,448,000	1.15 – 0.00
Interesi i përlogaritur	53,825		47,760	
Totali	5,558,507		5,239,158	

Depozitat bankare duke përjashtuar fondet përkatëse të garancisë kanë maturime që variojnë nga 6 muaj deri në 1 vit.

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***10. Investime të mbajtura me kosto të amortizuar**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	697,975	623,280
Interesi i akumuluar - investime të mbajtura me kosto të amortizuar	2,142	1,550
Totali	700,117	624,830

Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria ka investuar në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) and OTP Bank, me periudha maturimi ndërmjet një dhe shtatë vite dhe normë interesi fikse ndërmjet 4% dhe 4.5%. Obligacionet janë blerë në vlerën nominale të tyre. Këto instrumente janë cilësuar si jo në vonesë dhe as të zhvlerësuar në datën e raportimit. BKT është vlerësuar si BB (e qendrueshme) nga JCR ndërsa OTP Bank është vlerësuar BBB nga S&P.

11. Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Investimet e mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL) përbëhen nga indeksi "Global" i Fondit të Investimeve WVP. Më 31 dhjetor 2024, Shoqëria paraqitet me kuotat e mëposhtme të investuara në indeks më 14 shkurt 2022, të cilat me çmimin e tregut në fund të vitit janë si më poshtë

	2024		2023	
	Nr. i kuotave	Shuma në Lekë	Nr. i kuotave	Shuma në Lekë
Në fillim të vitit	-	-	-	-
Blerë gjatë vitit	2,496.0895	34,653,680	2496.0895	32,517,716
Vlera e drejtë në fund të vitit		2,689,101		2,135,964
Totali	2496.0895	37,342,781	2496.0895	34,653,680

12. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga policëmbajtësit	432,505	407,523
Llogari të arkëtueshme nga agjentët	6,236	2,634
Totali	438,741	410,157

Llogaritë e arkëtueshme nga policëmbajtësit bruto dhe neto nga zbritja për mosarkëtimet e mundshme janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit, bruto	735,137	690,457
Zbritja nga humbja e pritshme e kredisë (HPK)	(302,632)	(282,934)
Totali	432,505	407,523

12. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit (vazhdim)

Llogari të arkëtueshmet nga agentët nuk janë në vonesë dhe as të çvlerësuar. Lëvizjet për humbjet nga çvlerësimi janë detajuar si më poshtë:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	282,934	281,558
Çvlerësimi i njohur në fitim ose humbje	63,094	37,285
Fshirje nga llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	(43,396)	(35,909)
Totali	302,632	282,934

Cilësia kreditore për llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit nga policëmbajtësit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024			31 dhjetor 2023		
	Vlera kontabël bruto	Çvlerësimi	Vlera kontabël neto	Vlera kontabël bruto	Çvlerësimi	Vlera kontabël neto
Aktuale, as në vonesë as të çvlerësuar (deri në 3 muaj nga data e faturës) - 2%	242,896	(4,858)	238,038	212,028	(4,241)	207,788
Në vonesë por jo të çvlerësuar 3 deri në 6 muaj - 5%	58,338	(2,917)	55,421	74,672	(3,734)	70,937
Në vonesë por jo të çvlerësuar 6 muaj deri në 1 vit - 20%	118,772	(23,754)	95,018	118,102	(23,620)	94,482
Në vonesë prej më shumë se 1 vit - 60%	110,070	(66,042)	44,028	85,790	(51,474)	34,317
	530,076	(97,571)	432,505	490,592	(83,069)	407,524
Të çvlerësuar						
Më shumë se 1 vit me vonesë -100%	205,061	(205,061)	-	199,865	(199,865)	-
	735,137	(302,632)	432,505	690,457	(282,934)	407,524

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit në vonesë prej më shumë se 1 vit përfshijnë 110,070 mijë lekë (2023: 85,790 mijë lekë) përfshijnë balanca të papaguara nga furnitorët aktual të Shoqërise që do të kompensohen në të ardhmen kundrejt detyrimeve financiare.

Në vitin 2024 ato janë provizionuar në 60% të balancës së tyre bruto të papaguara dhe jo plotësisht (100%) që është norma e përdorur për llogaritë e tjera të arkëtueshme që janë në vonesë për më shumë se 1 vit nga data e faturës/primi. Shoqëria arkëtoi pagesa nga klientët e saj pas fundit të vitit në shumën prej 389,553 mijë lekë.

13. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pasuria	115,154	100,243
Sigurime motorike	251,767	262,636
Aksidente dhe shëndeti	53,111	41,417
Të tjera	6,907	5,429
Totali	426,939	409,725

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***13. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim (vazhdim)**

Lëvizjet në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë si më poshtë:

	2024	2023
Më 1 janar	409,725	449,517
Shtesa në shpenzimet e marrjes në sigurim të ndodhura gjatë vitit	829,246	823,109
Shpenzime të marrjes në sigurim (shënimi 26)	(812,032)	(862,901)
Totali	426,939	409,725

14. Aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga risiguresit	125,198	-
Pjesa e risiguresve në rezervën e primit të pafitur (shënimi 19)	294,025	233,288
Pjesa e risiguresve në dëmet e raportuara por të papaguara dhe në dëmet e ndodhura por të paraportuara (shënimi 18)	734,376	594,418
Totali	1,153,599	827,706

Aktivet e risigurimit të Shoqërisë nuk janë të siguruara, të vonuara apo të zhvlerësuar. Cilësia kreditore e aktiveve të risigurimit paraqitet në shënimin 6. (Rreziku kreditor).

15. Investime në filiale me kosto dhe borxhi i varur për filiale

Tabela më poshtë përmbledh lëvizjet e shumave të investimeve në filiale. Investimi përfaqëson kapitalin e kontribuar në filialet për 100% të interesit të pronësisë së mbajtur. Përgjatë vitit nuk kanë ndodhur lëvizje në këto investime.

Gjatë vitit 2021, Shoqëria ka dhënë një hua prej 1,000 mijë euro për filialin e saj në Maqedoninë e Veriut që operon në tregun e sigurimeve të jo-jetës, për t'i mundësuar filialit të përmbushë kërkesat minimale rregullatore. Borxhi ka një normë interesi prej 1.8% me maturim të pacaktuar dhe përdoret vetëm për mbulimin e rezervave teknike.

	Vendi i themelimit	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Investime të mbajtura me kosto			
Sigal Uniqa Group Austria	Kosovë	554,409	554,409
Sigal Life Uniqa Group Austria	Kosovë	491,728	491,728
Uniqa Life A.D.	Maqedonia e Veriut	488,040	488,040
Sigal Life Uniqa Group Austria	Shqipëri	369,999	369,999
Uniqa A.D.	Maqedonia e Veriut	318,874	318,874
		2,223,050	2,223,050
Borxhi i varur – Uniqa A.D.	Maqedonia e Veriut	104,317	108,536
		2,327,367	2,331,586

16. Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale, aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime qiraje

	Toka	Ndërtesa	Mjete motorike	Pajisje kompjuterike dhe zyre	Përmirsimet e qirasë	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2023	82,853	1,424,149	168,322	449,163	38,052	2,162,539
Shtesa	-	57,539	51,918	11,719	-	121,176
Pakësime	-	(58,706)	(22,227)	(37,807)	-	(118,740)
Më 31 dhjetor 2023	82,853	1,422,982	198,013	423,075	38,052	2,164,975
Shtesa	-	90,770	640	9,061	-	100,471
Pakësime	-	(14,861)	(10,072)	-	-	(24,933)
Më 31 dhjetor 2024	82,853	1,498,891	188,581	432,136	38,052	2,240,513
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2023	-	(674,680)	(127,378)	(348,303)	(33,087)	(1,183,448)
Shpenzimi i vitit	-	(109,180)	(11,800)	(21,914)	(3,805)	(146,699)
Pakësime	-	28,332	17,643	34,451	-	80,426
Më 31 dhjetor 2023	-	(755,528)	(121,535)	(335,766)	(36,892)	(1,249,721)
Shpenzimi i vitit	-	(105,330)	(15,309)	(17,453)	(1,160)	(139,252)
Pakësime	-	9,464	9,301	-	-	18,765
Më 31 dhjetor 2024	-	(851,394)	(127,543)	(353,219)	(38,052)	(1,370,208)
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2023	82,853	667,454	76,478	87,309	1,160	915,254
Më 31 dhjetor 2024	82,853	647,497	61,038	78,917	-	870,305

Shpenzimet e amortizimit njihen si “shpenzime administrative” në fitim ose humbje. Asnjë aktiv nuk është lënë peng si kolateral apo garanci. Toka është në pronësi të Shoqërisë dhe mbahet për projektet e ardhshme të zhvillimit për përdorim të biznesit të Shoqërisë (si qendër trajnimit).

Në kategorinë e ndërtesave paraqitur si mësipër, Shoqëria përfshin gjithashtu qiratë e ndërtesave përveç ndërtesave në pronësi. Kontratat e qirasë zakonisht lidhen për 5 vjet kusht që mund të ushtrohet nga Shoqëria për të zgjatur kontratën me 5 vite të tjera. Shoqëria ka konsideruar 10 vite si afat të këtyre qirave duke pasur në konsideratë synimet e saj dhe fleksibilitetin e kontratës.

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***16. Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale, aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime qiraje (vazhdim)**

Lëvizjet në koston dhe amortizimin e aktiveve me të drejtë përdorimi dhe vlerave kontabël paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2023	503,108	503,108
Shtesa	56,443	56,443
Përfundime të kontratave	(7,186)	(7,186)
Më 31 dhjetor 2023	552,365	552,365
Shtesa	49,498	49,498
Përfundime të kontratave	(14,862)	(14,862)
Më 31 dhjetor 2024	587,001	587,001
Amortizimi		
Më 1 janar 2023	(349,797)	(349,797)
Shpenzimi i vitit	(94,574)	(94,574)
Përfundime të kontratave	6,703	6,703
Më 31 dhjetor 2023	(437,668)	(437,668)
Shpenzimi i vitit	(93,808)	(93,808)
Përfundime të kontratave	9,464	9,464
Më 31 dhjetor 2024	(522,012)	(522,012)
Vlera neto kontabël		
Më 31 dhjetor 2023	114,697	114,697
Më 31 dhjetor 2024	64,989	64,989
<i>Shoqëria ka njohur detyrime qiraje si më poshtë:</i>	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime qiraje - afatshkurtra	51,551	86,294
Detyrime qiraje - afatshkurtra	23,708	39,683
Totali i detyrimeve të qirasë	75,259	125,977

Shoqëria ka 86 kontrata qiraje (2023 – 83 kontrata) për ndërtesa, për të cilat ka njohur të drejtën e përdorimit për 10 vitet e mbetura. Çdo qira në përgjithësi përmban një kufizim që, përveç rastit kur Shoqëria ka një të drejtë kontraktuale për të dhënë me nënqira aktivin të një palë tjetër, e drejta e përdorimit mund të përdoret vetëm nga Shoqëria. Qiratë ose nuk janë të anulueshme ose mund të anulohen vetëm duke marrë një tarifë të konsiderueshme përfundimi.

Shpenzimet e interesit të përfshira në shpenzimet financiare të vitit 2024 janë 4,492 mijë lekë (2023: 6,662 mijë lekë).

Sigal Uniq Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***17. Aktive të tjera**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime të filialeve	6,410	9,281
Paradhënie ndaj punonjësve	12,199	8,441
Aktive të tjera financiare	18,609	17,722
Garancia e parapaguar për sigurimin e kartonit jeshil	11,042	11,687
Parapagimet për furnitorët e shërbimeve	12,587	29,725
Paradhëniet në fondin e kompensimit	5,979	3,012
Aktive të tjera	19,900	16,979
Paradhënie për sigurimet shëndetësore	7,420	10,393
Paradhënie për agjentët	8,469	8,360
Paradhënie për ndërmjetësimin e dëmeve	7,692	5,733
Të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimit	183	209
Totali	91,880	103,820

18. Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme

	2024			2023		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Dëme të raportuara	1,822,950	(551,575)	1,271,375	1,732,429	(621,459)	1,110,970
Dëme të ndodhura por të raportuara	1,320,261	(42,843)	1,277,418	1,161,664	(11,423)	1,150,241
Shpenzimet e administrimit të dëmeve	41,988	-	41,988	35,101	-	35,101
Në fillim të vitit	3,185,199	(594,418)	2,590,781	2,929,194	(632,882)	2,296,312
Dëme të raportuara	2,490,397	(457,078)	2,033,319	1,647,440	(74,695)	1,572,745
Dëme të ndodhura por të raportuara	(2,042,279)	317,120	(1,725,159)	(1,384,549)	113,159	(1,271,390)
Shpenzimet e administrimit të dëmeve	(1,408)	-	(1,408)	(6,886)	-	(6,886)
Lëvizjet gjatë vitit	446,710	(139,958)	306,752	256,005	38,464	294,469
Totali në fund të vitit	3,631,909	(734,376)	2,897,533	3,185,199	(594,418)	2,590,781
Dëme të raportuara	2,196,634	(682,762)	1,513,872	1,822,950	(551,575)	1,271,375
Dëme të ndodhura por të raportuara	1,394,696	(51,614)	1,343,082	1,320,261	(42,843)	1,277,418
Shpenzimet e administrimit të dëmeve	40,579	-	40,579	41,988	-	41,988

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***18. Detyrime të kontatave të sigurimit për dëme (vazhdim)**

Dëmet e paguara sipas produkteve janë si më poshtë:

	2024	2023
Mjete motorike	1,374,179	961,222
Shëndeti dhe aksidente	324,090	265,164
Prona	327,196	151,544
Të tjera	16,813	6,619
Totali	2,042,279	1,384,549

Rezerva e dëmeve të raportuara të papaguara	2024	2023
Më 1 janar	1,822,950	1,732,429
Dëme të paguara të periudhës së mëparshme	(689,184)	(776,235)
Dëmet e reja gjatë vitit dhe rishikimi i vlerësimit	1,062,868	866,756
Gjëndja më 31 dhjetor	2,196,634	1,822,950

Rezerva e dëmeve të ndodhura të paraportuara	2024	2023
Më 1 janar	1,320,261	1,161,663
Ndryshimi neto gjatë vitit	74,435	158,598
Gjëndja më 31 dhjetor	1,394,696	1,320,261

19. Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafituar

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	2,663,953	2,497,689
Prime të shkruara gjatë vitit (shënimi 23)	5,729,743	5,499,080
Prime të fituara gjatë vitit	(5,448,337)	(5,332,816)
Gjëndja më 31 dhjetor	2,945,359	2,663,953

	2024	2023
Ndryshimi bruto në rezervën për primin e pafituar	281,406	166,264
Ndryshimi në pjesën e risiguruesve	(60,737)	(33,906)
Ndryshimi në rezervën për primin e pafituar, neto	220,670	132,358

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***20. Detyrime të tjera**

	2024	2023
Furnitorë të mallrave dhe shërbimeve	219,137	243,041
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënimi 32)	26,343	62,477
Komisionet e pagueshme për agjentët	94,548	81,217
Detyrime të tjera financiare	340,028	386,735
Detyrimet e TVSH-së	9,281	10,176
Detyrime të tjera tatimore	63,301	63,467
Totali	412,610	460,378

21. Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2024 kapitali i paguar është i barabartë me 2,232,909 mijë lekë (2023: 2,232,909 mijë lekë). Kapitali aksionar përbëhet nga 551,608 aksione të autorizuara dhe të paguara tërësisht me një vlerë nominale prej 4,048 lekë. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 struktura e aksionarëve është si më poshtë. Shuma e dividendit për aksion të shpërndarë në vitin 2024 ishte 543,86 lekë.

	Nr. i aksioneve	Në lekë '000	Në %
UNIQA Österreich Versicherungen AG	496,448	1,898,200	90.00%
Z. Avni Ponari	55,160	334,709	10.00%
	551,608	2,232,909	100%

22. Rezerva e rrezikut të sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në Ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të mbartura prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk duhet të rritet më tepër nëse vlera e saj përafrohet me 30% të primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë.

23. Prime të shkruara bruto

Prime të shkruara bruto të sigurimit dhe të risigurimit sipas produkteve detajohen si më poshtë:

	2024	2023
Mjete motorike	3,521,758	3,272,613
Prona	1,393,992	1,444,212
Shëndeti dhe aksidentet	701,032	656,975
Mjete detare dhe aviacionit	102,439	111,218
Risigurimi	10,522	14,062
Totali	5,729,743	5,499,080

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***23. Prime të shkruara bruto (vazhdim)**

Primet e mjeteve motorike detajohen si më poshtë:

	2024	2023
Motorike (detyrime ndaj palëve të treta)	2,614,998	2,393,045
Kartoni jeshil	467,024	453,417
Kasko	343,490	319,990
Sigurimi kufitar	96,246	106,161
Totali	3,521,758	3,272,613

24. Prime të shkruara ceduar risiguruesve

Primet e ceduara te risiguruesit sipas produkteve të sigurimit detajohen si më poshtë:

	2024	2023
Prona	733,450	791,760
Marinë dhe aviacion	39,293	59,500
Shëndeti dhe aksidentet	72,908	78,103
Mjete motorike	37,797	37,456
Totali	883,448	966,819

25. Të ardhura të tjera

	2024	2023
Shërbime ndërmjetësimi dhe tarifa	20,012	27,510
Të ardhura nga qiratë dhe logjistika	10,271	10,565
Rimbursimi i dëmeve	23,453	22,250
Të ardhura të tjera	13,994	15,189
Totali	67,730	75,514

26. Shpenzime të marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim, sipas linjave të biznesit detajohen si më poshtë:

	2024	2023
Prona	155,696	186,472
Mjete motorike	534,303	539,567
Aksidente dhe shëndeti	106,680	109,180
Të tjera	15,353	27,682
Totali	812,032	862,901

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***27. Shpenzime administrative**

	2024	2023
Shpenzime personeli	608,275	486,887
Shërbime të tjera të jashtme	151,051	132,870
Shpenzime marketingu	163,557	150,894
Shpenzime të tjera administrative	174,998	182,606
Amortizimi (shënimi 12)	139,252	146,700
Humbje nga çvlerësimi (shënimi 12)	63,095	37,285
Shpenzime telekomunikacioni	13,215	13,495
Taksa lokale	20,745	17,435
Penalitete	3,604	2
Totali	1,337,792	1,168,174

Në 2024, numri mesatar i punonjësve në Shoqëri ishte 298 (2023: 295 punonjës). Në shumën e shpenzimeve të personelit të treguar më sipër, Shoqëria përfshin 48,104 mijë lekë (2023: 50,647 mijë lekë) kontribute për përfitimet e pensionit të punonjësve.

Tarifat e auditimit të jashtëm për vitin 2024 janë 7,963 mijë lekë dhe përfshihen në shërbime të tjera të jashtme (2023: 8,880 mijë lekë). Audituesi i jashtëm nuk ka ofruar asnjë shërbim jo-auditimi ndaj Shoqërisë.

28. Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit

	2024	2023
Kontributi për AMF	79,537	71,870
Fondi i kompensimit	57,037	87,841
Shpenzime për blerjen e policave dhe shpenzime të tjera	4,202	3,438
Totali	140,777	163,149

29. Të ardhurat nga investimet dhe interesat

	2024	2023
Të ardhura nga interesi	127,247	76,672
Dividendë të arkëtuar	174,879	85,727
Totali	302,126	162,398

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)***30. Tatim mbi fitimin**

Shpenzimet tatimore për periudhën përfshijnë vetëm tatimin aktual mbi fitimin e vitit. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin janë si më poshtë:

	2024	2023
Shpenzimi i tatim mbi fitimin	47,985	58,760
Shpenzimi i tatim fitimi i shtyrë	-	-
	47,985	58,760

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në masën 15% (2023: 15%) të të ardhurave të tatueshme. Një rakordim ndërmjet tarifës tatimore të pritshme dhe asaj aktuale paraqitet si më poshtë:

	2024	2023
Fitimi para tatimit	447,223	392,471
Tatimi i llogaritur me 15%:	67,083	58,871
Të ardhurat që nuk i nënshtrohen tatimit	(26,232)	(12,859)
Shpenzime të pazbritshme		
- kompensimi i borxhit të keq	6,509	5,386
- tarifat dhe penalitetet	4,279	7,156
- provizione të tjera	(3,654)	206
	47,985	58,760

Shoqëria nuk ka njohur vlerën prej 11,228 mijë lekë të aktive për tatime të shtyra dhe vlerën prej 9,748 mijë lekë të detyrime për tatime të shtyra (neto në vlerën prej 1,479 mijë lekë të aktiveve për tatime të shtyra) që lidhen me aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë në datat e raportimit pasi janë konsideruar jo-materiale për pasqyrat financiare.

Tatim fitimi i arkëtueshëm/(i pagueshëm) në datën e raportimit përbëhet nga lëvizjet si më poshtë:

	2024	2023
Më 1 Janar	51,705	(25,309)
Shpenzimi i tatim fitimit	(47,985)	(58,760)
Parapagimet e tatim fitimit	16,818	135,774
Më 31 dhjetor	20,538	51,705

31. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Shoqëria është e përfshirë në çështje dëmsh në proces gjyqësor dhe veprime të ndryshme ligjore. Sipas parashikimit të drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshimet në aktivet neto. Çështjet ligjore, në të cilat paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria janë të zakonshme. Drejtimi vlerëson dëmet e ndodhura duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme konsulentësh ligjorë. Drejtimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme megjithatë pranon se rezultati mund të jetë më i lartë ose më i ulët se shuma e parashikuar. Më 31 dhjetor 2024 rezultuan 222 raste ende në proces gjyqësor për të cilat kërkesat e klientëve ishin në total 531.832 mijë lekë më shumë se shuma e ofruar nga Shoqëria (2023: 189 raste ende në proces gjyqësor për të cilat kërkesat e klientëve ishin në total 643,360 mijë lekë më shumë se shuma e ofruar nga Shoqëria). Vlerësimet dhe dispozitat e Shoqërisë bazohen në pritshmëritë e konsulentëve ligjorë, vendimet e gjykatës së shkallës së parë, përvojën e kaluar dhe një analizë "shikimi prapa" të dëmeve në proces gjyqësor.

32. Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen si të jenë të lidhura në qoftë se ato janë nën kontroll të përbashkët ose në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm apo kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet llojit të marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore. Palët e lidhura me të cilën Shoqëria ka patur transaksione janë të shënuara më poshtë:

Palët e lidhura	Marrëdhënia
UNIQA Österreich Versicherungen	Mëma përfundimtare
Avni Ponari	Administrator/Aksionar/Drejtimi kryq
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A (Kosovo)	Filial/Nën kontroll
UNIQA Life AD Skopje	Filial/Nën kontroll
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A (Kosovo)	Filial/Nën kontroll
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA SH.A	Filial/Nën kontroll
SHAFF Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A	Filial/Nën kontroll/Indirekt
UNIQA Re	Shoqëri brenda grupit
UNIQA Vaduz	Shoqëri brenda grupit
Uniqa IT-Services	Shoqëri brenda grupit
Uniqa Insurance	Shoqëri brenda grupit
SIGAL AD	Shoqëri e zotëruar nga administratori
Sigal Business Centre	Shoqëri e zotëruar nga administratori
Avel sh.p.k.	Shoqëri e zotëruar nga administratori
Alto sh.p.k	Shoqëri e zotëruar nga administratori

Gjatë vitit Shoqëria ka pasur transaksionet e mëposhtme me palët e lidhura:

Shpenzime ndaj	Lloji	2024	2023
UNIQA RE	Prime të ceduara	111,331	142,879
UNIQA Österreich Versicherungen AG	Prime të ceduara	28,469	26,826
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.	Qira	698	240
Sigal Business Center	Qira	35,390	38,297
UNIQA Insurance	Tarifa e drejtimit kryq	30,225	30,158
Uniqa IT-Services	Shërbime	15,162	20,076
Avel sh.p.k.	Shërbime	126,906	170,594
Avni Ponari	Qira	1,640	1,773
SIGAL AD	Shërbime	6,645	6,112
SHAFF	Kontribute për punonjësit	18,470	6,408

Sigal Uniqa Group Austria SH.A.**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale – 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***32. Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)**

Të ardhura nga	Lloji	2024	2023
UNIQA RE	Dëme të paguara nga risiguruesi	192,480	52,059
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.(Kosovo)	Risigurime	5,660	3,211
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.	Dividendë	174,879	85,726
UNIQA AD North Macedonia	Shërbime	1,509	1,586
UNIQA Life North Macedonia	Risigurime	1,727	1,133
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a. (Kosovo)	Shërbime	2,427	5,909
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.	Qira	9,297	6,517
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.	Risigurime	1,818	1,987
SIGAL AD	Qira	221	154
SHAFFP	Qira	3,529	3,397
Dividendë të paguar			
		2024	2023
Uniqa		304,255	260,790
Avni Ponari		35,000	30,000
Edvin Hoxhaj		10,745	9,210
		350,000	300,000

Në datën e raportimit balancat me palët e lidhura janë si më poshtë:

	Lloji	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
UNIQA RE	Aktive risigurimi	125,197	(26,239)
UNIQA Insurance	Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit	(15,234)	(30,158)
Sigal AD	Detyrime të tjera	(786)	(535)
Avel Sh.p.k.	Detyrime të tjera /parapagime	(115)	337
UNIQA AD, – MNK	Borxhi i varur	104,317	108,537
UNIQA LIFE AD – MNK	Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	2,014	618
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.A (Kosovë)	Llogari të tjera të arkëtueshme	(11,109)	(3,826)
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.A.	Llogari të tjera të arkëtueshme	5,391	(2,254)
Sigal Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.A (Kosovo)	Llogari të tjera të arkëtueshme	2,668	639
SHAFFP Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.A	Llogari të tjera të arkëtueshme	1,728	8,024

Gjatë vitit 2021, Shoqëria ka dhënë ndaj filialit të saj Uniqa MK AD një hua për të mbuluar rezervat e saj teknike me një afat të pacaktuar. e cila mban një interes prej 1.8% p.a.

Drejtimi kryq përfshin anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorin e përgjithshëm. Tarifat që i janë paguar drejtimit kyç për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë 147,726 mijë lekë, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 ishin 93,241 mijë lekë dhe përbëhen nga pagat dhe shpërblimet. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, Shoqëria ka raportuar një kapital prej 4,515,927 mijë lekë (2023:4,466,686 mijë lekë).

33. Menaxhimi i kapitalit

Niveli i aftësisë paguese 1,853,355 mijë lekë (2023: 1,776,153 mijë lekë), dhe niveli i mbulimit të aktiveve në përqindje për mbështetjen e detyrimit të sigurimit është 125.80 % (2023: 128.78%) mbi nivelet e kërkuara nga ligji dhe aktet rregullatore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Menaxhimi i rrezikut në kapital

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga kapitali që i atribuohet zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë, që përfshin kapitalin e emetuar, rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Shoqëria menaxhon kapitalin e saj për të siguruar ruajtjen e nivelit të duhur të kapitalit që Shoqëria të jetë në gjendje të vazhdojë aktivitetin në vijimësi dhe të jetë në përputhje me kërkesat e rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin tek palët e interesuara përmes një optimizimi të balancave të borxhit dhe kapitalit. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, Shoqëria përmbushi të gjitha kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit, duke përfshirë nivelin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve që mbulojnë detyrimet e kontratave të sigurimit.

Në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", shoqëritë e sigurimit në Shqipëri llogarisin kapitalin rregullator në datën e raportimit duke e krahasuar atë me aftësinë paguese të kërkuar. Kapitali i shoqërive të sigurimit duhet të jetë së paku më i madhi se fondi i garancisë së Shoqërisë në datën e raportimit dhe 150% e aftësisë paguese të kërkuar të llogaritur në përputhje me Ligjin e Sigurimeve.

Për aftësinë paguese të kërkuar të Shoqërisë referohuni tek skedulet plotësuese.

Shënimi	2024	2023
Totali i kapitalit	4,515,927	4,466,689
Aftësia paguese e kërkuar	728,487	816,878
150% i aftësisë paguese të kërkuar	1,092,730	1,225,317
Në % e kapitalit	24.2%	27.4%
Fondi i garancisë	9	740,000
Në % të aftësisë paguese të kërkuar	102%	91%

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në legjislacionin vendas që impaktojnë aktivitetin në të cilin Shoqëria operon mund të ndikojnë në fitimin e gjeneruar të saj. Aktiviteti i sigurimeve i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhueshme gjithëpërfshirëse. Qëllimi kryesor i rregulloreve është mbrojtja e policë-mbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret ekzistuese të sigurimeve mund të ndikojnë në mënyrën në të cilën Shoqëria zhvillon biznesin e saj dhe produktet e ofruara. Për më tepër, ligjet ose rregulloret e sigurimeve të miratuara dhe të ndryshuara herë pas here mund të jenë më kufizuese ose mund të rezultojnë në kosto më të larta se kërkesat aktuale.

34. Ngjarje pas datës së raportimit

Më 11 Prill 2025, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i Shqipërisë ("AMF") miratoi ndryshimet në statutin e Shoqërisë, së bashku me ndryshimet në strukturën e aksionarëve, në përputhje me marrëveshjen për blerjen e aksioneve të përmendur në Shënimin 1 të këtyre pasqyrave financiare individuale. Megjithatë, këto ndryshime ende nuk kanë hyrë në fuqi, pasi marrëveshja për blerjen e aksioneve kërkon që edhe autoritetet e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut të miratojnë ndryshimet përpara se struktura e re të formalizohet dhe aksionet të transferohen nga UNIQA Österreich Versicherungen AG te Sigal Business Center SH.P.K. Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim ose zbulesa shtesë në këto pasqyra financiare individuale.

Skedule plotësuese (të paaudituara)**Marzhi i aftësisë paguese**

Marzhi i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbehet si më poshtë:

	2024	2023
<i>a) Shkalla e kerkuar e marzhit bazuar ne primet</i>	816,878	816,878
<i>b) Shkalla e kerkuar e marzhit bazuar ne demet</i>	359,356	359,356
Marzhi i kerkuar - maksimalja e (a) dhe (b)	816,878	816,878
<i>b) Niveli aktual i marzhit te aftesise paguese:</i>		
Kapitali aksionar	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	260,496	260,496
Fitimet e mbartura	2,022,522	1,973,284
Investimet ne filiale me kosto	(2,223,050)	(2,223,050)
Aktive të tjera të zbritshme në llogaritjen e kapitalit	(439,523)	(467,486)
Niveli aktual i marzhit te aftesise paguese	1,853,354	1,776,153

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.

Skedule plotësuese (të paaudituara) – 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përvec rasteve kur është shprehur ndryshe)

Aktivët në mbulim të detyrimeve të sigurimit

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 96 datë 3 shkurt 2008, ndryshuar me Vendimin nr.5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit mund të investojnë jo më shumë se raportet e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve që mbulojnë rezervat teknike dhe matematikore:

Provizionet bruto teknike dhe matematikore	31 dhjetor 2024		
		(A)	6,577,268
	Limiti i Investimit si përqindje e provizionit bruto	Limiti i investimit sipas rregullores	Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit
Toka dhe ndërtesa	30%	1,973,181	637,039
Depozita me afat (me përjashtim të fondit të garancisë)	pa limit		4,775,724
Investime në bono thesari (me përjashtim të fondit të garancisë)	pa limit		-
Aktivët e risigurimit (klasifikimi i sipërm BBB-)	pa limit		1,153,599
Letrat me vlerë të tregtuara në treg të parregulluar	35%	2,302,044	735,318
Sigurime dhe të arkëtueshme të tjera (më pak se 3 muaj)	20%	589,072	244,274
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj	3%	197,318	105,262
Investimet në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	328,863	139,955
Interesi i përlogaritur dhe shpenzimet e parapaguara	5%	328,863	55,968
Shpenzimet e parapaguara	15%	441,804	426,939
Totali B			8,274,078
Niveli i mbulimit të aktiveve në përqindje për mbështetjen e detyrimit të sigurimit	B/A		125.80%